



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.527 prot., i AK, datë 30.08.2022, “Përqendrimi ndërmjet Aramco Overseas Company B.V./ Valvoline Global Products Business”.

Referuar “Marrëveshje për blerje kapitali”, palët janë:

**Blerësi: Gateway Velocity Holding Corp.**, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, e themeluar për qëllime të caktuara, e angazhuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në çdo akt apo aktivitet të ligjshëm për të cilin mund të organizohen korporatat sipas DGCL (Ligji për Korporatat të Shtetit të Delaware).

**Shitësi: Valvoline Inc.**, është një kompani publike, e themeluar në Amerikë, një nga tregtarët dhe furnizuesit kryesor në mbarë botën i lubrifikantëve të markës premium dhe shërbimeve të automobilave.

**Shoqëria Target: VGP Holding LLC**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar posaçërisht për qëllimin e marrjes së një prej segmenteve të biznesit të Valvoline (Biznesi i Produkteve Globale), gjatë procesit të riorganizmit të Shitësit përpara mbylljes së transaksionit.

Shoqëria target nuk ka degë të regjistruara në Shqipëri, por ajo shet kryesisht produkte lubrifikante dhe ftohës në Shqipëri, nëpërmjet një distributori vendas.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**